Lajme

Gazeta Express

29/11/2020 11:45

Dhjetë persona në Suharekë bëhen llom, gjuajnë edhe me armë zjarri

Tre persona në Suharekë kanë pësuar lëndime trupore pasi dyshohet se janë sulmuar fizikisht nga shtatë të tjerë, raporton Express

Rasti ka ndodhur mbrëmjen e së premtes në fshatin Budakovë të Suharekës, ka njoftuar Policia e Kosovës në raportin 24 orësh.

Lexo Edhe:
Të shtëna me armë zjarri në Podujevë, ndalohet një 58-vjeçar

Policia ka njoftuar se në vendngjarje ka pasur edhe të shtëna me armë zjarri.

"Tri viktima meshkuj kosovar (në rrethana ende të pasqaruara) kanë pësuar lëndime, pasi që dyshohet se të njëjti janë sulmuar fizikisht nga shtatë (7) persona dhe po ashtu dyshohet se, dikush nga të dyshuarit kishte shtënë me armë zjarri në ajër. Viktimat pas tretmanit mjekësor në QKMF-Suharekë janë liruar", ka njoftuar policia.

Po ashtu, është bërë e ditur se në vendin e ngjarjes janë gjetur fishekë dhe një gëzhojë.

Nga një i dyshuar është konfiskuar një pistoletë me dy karikatorë dhe tetë fishekë.

"Në vendin e ngjarjes është gjetur një gëzhojë cal. 9mm dhe një fishekë. Po ashtu policia ka arrestuar pesë persona të dyshuar meshkuj kosovar. Nga njëri i dyshuar është konfiskuar një pistoletë me dy karikator dhe tetë fishekë cal. 9mm. Me vendim të prokurorit një nga të dyshuarit është dërguar në mbajtje ndërsa të tjerët janë liruar në procedurë të rregullt", bëhet e ditur në njoftim./*GazetaExpress*/

Share Now

Të ngjashme

Me i fundit

Zidane zbulon listën për Shakhtarin 48 orë para ndeshjes, kthehet

Te fundit

Zidane zbulon listën për Shakhtarin 48 orë para ndeshjes, kthehet Benzema

LSDM pyet Mickoskin: Me kë po bashkëpunon në Bullgari?!

Të shtëna me armë zjarri në Podujevë, ndalohet një 58-vjeçar

Aksident me pasojë vdekje në superstradën Lezhë-Milot

ZAEV: Në BE do të anëtarësohemi si maqedonas të cilët flasin gjuhën maqedonase

"E mbuloja me plastmas që mos e lagte shiu", babai i plotëson vajzës kërkesën nga fëmijëria

All rights are reserved